# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443480**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Miratohet rritja e pagave për gjyqtarët/ Komisioni i Ekonomisë kalon draftin e propozuar nga PS me rritje 8500 lekë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/14/miratohet-ne-parim-rritja-e-pagave-per-gjyqtaret-komisioni-i-ekonomise-kalon-draftin-e-propozuar-nga-ps-me-rritje-8500-leke/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 14:43:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 14:36:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 14:35:00 UTC → 14 shtator 2026, 14:37:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f5e2292994effdce924deb345d66cc29ced6c17512a2e025ec8cd8d106dc456b` |
| TEKSTI | `c2792bfecccaf80dc0738c64309a79562e3d553c4f26d179dc3bda8e9a6c7108` |
| PAMJA | `457262b20e25601e635abc0bb3951c9f23783edfa31fbe888ffb40433db41057` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `02804c3ab27d310afd1185c84287763fc35fbfc21bf5d622f7b61043a67ea870` |
| E MËPARSHMJA | `21e8f6ff94aa1319e7f53c2cbc0034f1f294c33ece01f27595be05b94e2c0e87` |
| RRËNJA MERKLE | `e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/02804c3ab27d310afd1185c84287763fc35fbfc21bf5d622f7b61043a67ea870`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# Miratohet rritja e pagave për gjyqtarët/ Komisioni i Ekonomisë kalon draftin e propozuar nga PS me rritje 8500 lekë

14/09/2026 16:36



**Me 8 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim Komisioni i Ekonomisë miratoi në parim draftin e mazhorancës për pagat e magjistratëve.**

Drafti i PS parashikon një rritje nga 36% në 38% të pagës së Presidentit të Republikës, me rreth 8500 lekë për rrogën referuese të magjistratëve, ndërkohë që pretendimi i tyre, (i miratuar edhe nga KLGJ e KLP) është 9-fish më i lartë.

Mes debateve me opozitën mazhoranca argumentoi se formula e propozuar zbaton vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa qëndrojnë të mendimit se askush që nuk është i autorizuar me ligj nuk mund të vendosë për paratë e Thesarit të Shtetit.

Deputetja e Partisë Socialiste, Aulona Bylykbashi, e cila është propozuesja e draftit për ndryshimin e pagave të magjistratëve, sqaroi se Gjykata nuk ka imponuar një formulë të vetme numerike për përcaktimin e pagave, por ia ka lënë ligjvënësit zgjedhjen e modelit, me kusht që të respektohen standardet kushtetuese.

*"E rëndësishme se gjykata nuk ka imponuar një formulë të vetme numerike zgjedhja e modelit është tërësisht në diskrecionin e ligjvënësit me kusht që të respektojë standardet kushtetuese. Ndryshimi i parë paga referuese bazë. Në nenin 1 propozojmë që koeficienti i pagës të kalojë nga 0.36-0.38% të pagës së Presidentit të Republikës. Koeficienti 0.38% shifër si rezultat i një vlerësimi. Paga nuk është e izoluar paga bruto përfshin përkatësinë në grup, vjetërsinë"*, tha Bylykbashi.

Ndërsa deputeti i Partisë Socialiste, Erion Braçe, kritikoi vendimin e gjyqtarëve për çështjen e pagave, duke thënë se me këtë vendimmarrje janë marrë kompetenca që i takojnë Kuvendit:

*"Vendimi i tyre jo që s'ka pyetur deputetët, por ka marrë kompetencat e deputetëve. Vendimi i GJK nuk i kërkon KLGJ dhe KLP të caktojë rrogën e prokurorëve dhe gjyqtarëve, por parlamentit. Akti që kanë bërë nuk ka bazë ligjore, po është akt i kallëzueshëm. Akt vetëgjyqësie i paprecedentë në këtë vend, ndërkohë që duhet të kishte ndodhur e kundërta. Të detyrojë thesarin të paguajë për rritje në pagesat mendoj kemi humbur seriozitetin dhe i kemi vënë shkelmin parasë publike në këtë vend. Gjithkush duhet të kuptojë që ato para nuk janë paratë e atyre që kanë fuqi për të marrë vendime. Por janë paratë e taksapaguesve."*

Projektligji mori mbështetjen edhe të qeverisë. Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë tha se koeficienti 0.38 plotëson kushtet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa Ministria e Financave e konsideroi të përballueshme koston për buxhetin.

Ndërsa opozita e kundërshtoi draftin me arsyetimin se qeveria nuk po respekton vendimet e Kushtetueses.

Për deputetin e Partisë Demokratike, Eno Bozdo, situata e krijuar me pagat është pasojë


## Kryesore



25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"
15:17

Bllokuan akset kryesore të Tiranës gjatë tubimit të djeshëm, procedohen penalisht 20 protestues
11:32

E rëndë në Roskovec/ Theu urdhrin e mbrojtjes dhe shkoi në banesën e ish-partneres, 59-vjeçari plagos me drapër ish-vjehrrin
12:10

Trump paralajmëron fundin e luftës në Iran: Mund të ndodhë rreth zgjedhjeve amerikane
07:48

Premier League pranon gabimin: Goli i Haaland ndaj Manchester United nuk duhej të ishte quajtur i rregullt
11:22

## Më të lexuarat

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave

Kishte dalë me leje nga burgu, "tmerri" i policisë greke Alket Rizai hap zjarr në lokal pas sherrit për muzikën, disa të plagosur

Ilir Meta del nga kafazi! Gjykata e Apelit pranon kërkesën e ish-presidentit, shtyhet shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e masës

"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë"/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar

Video/ Polici goditi me grusht në bark qytetarin në protestë, Skënder Hita pezullon efektivin e "Shqiponjave"

Alket Rizai shpallet në kërkim në Greqi, duhej të kthehej në burg në orën 8:00 pas incidentit në lokal

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Drejtësia kërkon drejtësi… për rrogën e vet!

E rëndë në Roskovec/ Theu urdhrin e mbrojtjes dhe shkoi në banesën e ish-

Për deputetin e Partisë Demokratike, Eno Bozdo, situata e krijuar me pagat është pasojë e mosrespektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga qeveria.

*"Çdo gjë ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të disa herëve se qeveria nuk çan kokën për vendimet e Kushtetueses. Më habit fakti që edhe pse Kuvendi e ka deleguar nismën që në prill të këtij viti qeverisë dhe nisma s'vjen nga qeveria, po nga dy kolegë të nderuara. Këshilli i Legjislacionit i ka kërkuar qeverisë shqiptare të paraqesë projektligjin. Kemi këtu përfaqësuesin e Min. së Drejtësisë që është shumë i kënaqur. Na mungon fatura e plotë financiare, por ne nuk i kemi në projektrelacion këto shifra, pa to s'bëjmë dot",* tha Bozdo.

Ndërsa deputeti i Partisë Demokratike, Bujar Leskaj, i cilësoi si të paligjshme vendimet e KLGJ-së dhe KLP-së për pagat dhe tha se Kuvendi nuk duhet t'i "bëhet violinë" kryeministrit Edi Rama.

*"KLGJ dhe KLP për mua janë në paligjshmëri me ato vendime, ne duhet të kërkojmë zbatimin e ligjeve të kushtetuese apo tu bëhemi violin e një kryeministri të papërgjegjshëm i cili e krijoi këtë situatë për shantazh ndaj sistemit të drejtësisë ",* deklaroi deputeti Leskaj në komisionin e Ekonomisë

Kriza e pagave në sistemin e drejtësisë kulmoi pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik 2026 formulën e re të pagave, siç kishte kërkuar Gjykata Kushtetuese. Pas kalimit të afatit, më 26 gusht KLGJ dhe dy ditë më pas KLP e përcaktuan vetë pagën referencë të gjyqtarëve e prokurorëve, me një rritje të konsiderueshme. Por Ministria e Financave nuk i ekzekutoi listëpagesat me këtë përllogaritje, duke argumentuar se përcaktimi i pagave është kompetencë e Kuvendit.

**Top Channel**

partneres, 59-vjeçari plagos me drapër ish-vjehrrin

Gara për Prokuror të Përgjithshëm në ngërç, Arta Marku kërkon largimin e Sokol Stojanit nga procesi

## Aktualitet »




Viti i ri shkollor/ Shkodra ndal rënien e numrit të nxënësve, rreth 15 mijë nisin mësimin
14/09 16:05



Ilir Meta del nga kafazi! Gjykata e Apelit pranon kërkesën e ish-presidentit, shtyhet shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e masës
14/09 15:57



Shkollimi kushton deri në 30 mijë lekë në muaj, ekspertja e ekonomisë: Çiftet e reja po e mendojnë dy herë të kenë fëmijë
14/09 15:56



14 shtatori pa zilen e shkollës/ Fshati Neviçisht pranë Korçës zbrazet nga shpopullimi, nuk ka më asnjë nxënës
14/09 15:44




Mesazh kërcënues në rrjet social ndaj një 34-vjeçari në Tiranë, policia referon çështjen në Prokurori, nis hetimet për identifikimin e autorit
14/09 15:42



25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"
14/09 15:17

## Kryesore »



Bombardime të ashpra izraelite në Liban/ Të paktën 13 të vdekur, përfshirë gjashtë fëmijë
14/09 17:05



SHBA i shpalli luftë tregtare Kanadasë, Mark Carney me sytë te investitorët për të forcuar ekonominë, kërkon 1 trilion dollarë investime
14/09 16:48



Papa Leoni XIV rikthen 10% të pagës së kardinalëve të shkurtuar gjatë pandemisë, shfuqizon vendimin e vitit 2021 nga Papa Françesku
14/09 16:41













Shteti intensifikon shtypjen, qindra adoleshentë rusë përballen me aktakuza për terrorizëm

14/09 16:30

Gjermania dërgon deri në 1,000 ushtarë në Lituani, rritet gatishmëria e NATO-s përballë kërcënimit rus

14/09 16:27

Vuante prej kohësh nga Alzheimeri, ndërron jetë babai i Andy Burnham, kryeministri britanik anulon të gjitha angazhimet

14/09 16:19

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – 'Rrogat nga paratë e konfiskuara'. Edi Rama shënjestron argumentin e magjistratëve



Top News – Rrjeti B40 për Veliajn: 'Gjykata e Lartë të respektojë vendimin e Kushtetueses'



Top News- Protestë kundër kamerave në shkolla. Grushti pezullon efektivin e "Shqiponjave"



Top News- Ratko Mlladiç në PE/ Debat për lartësimin e 'Kasapit të Bosnjes' nga Serbia




Top Channel/ Meta del nga kafazi, Do ndjekë gjyqin për masën e sigurisë përkrah avokatit



Top News – 'Ndjek me kënaqësi zhvillimet…'/ Berisha flet për vizitën në SHBA dhe…Ballukun



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.